

**AKTET e Takimit Ndërkombëtar Vjetor
IASH 2007**

Prishtinë, 16-18 gusht 2007, Vëll. I, Nr. 1

**PROCEEDINGS of the International
Annual Meeting
IASH 2007**

Prishtina, 16-18 August 2007, Vol. I, Nr. 1

KRYEREDAKTOR / EDITOR-IN-CHIEF

Robert Magari (rmagari@hotmail.com)

Ph.D., Beckman Coulter Inc., Miami, Florida, USA

REDAKTORË / EDITORS

Arben Merkoçi (arben.merkoci.icn@uab.cat),

Prof.Dr., ICREA & Catalan Institute of Nanotechnology, Barcelona, Spain

Ardian Harri (ardian_harri@yahoo.com),

Assistant Prof., Department of Agricultural Economics, Mississippi State University, USA

Bajram Berisha (berisha@wzw.tum.de),

PD. Dr., Center of Life and Food Sciences, Technical University Munich, Germany and
Assoc. Prof., Faculty of Agriculture and Veterinary Science, University of Prishtina, Kosovë

Begzad Baliu (bbaliu@yahoo.com),

Ass. Prof. Dr., Faculty of Education, University of Prishtina, Kosovë

Eshref Januzaj (januzaj@dbs.informatik.uni-muenchen.de),

Dipl.-Inform. Univ. (M.Sc.) Technische Universität Braunschweig, Germany

Evan Rroço (rroco_ewan@yahoo.de),

Assoc. Prof., Dr., Faculty of Agriculture and Environment, University of Agriculture, Tirana, Albania

Gentian Zyberi (G.Zyberi@uu.nl),

Assistant Prof. Dr. Netherlands Institute of Human Rights (SIM), Utrecht University, The Netherlands

Kristaq Jorgo (kristjorgo@yahoo.com),

Dr., Faculty of History and Filology, University of Tirana, Albania

Lulzim Dragidella (lulzim.dragidella@web.de),

Dr., Lecturer in Regensburg University and University of Prishtina, Kosovë

Musa Rizaj (mrizaj@hotmail.com),

Assoc. Prof., Faculty of Mineralogy and Metallurgy, University of Prishtina, Kosovë

Naim Shabani (drnshabani@hotmail.com)

Dr. Med., Universitätsfrauenklinik Jena, Germany

Nebi Caka (nebi.caka@fiek.uni-pr.edu),

Assoc. Prof. Dr., Faculty of Electrical and Computer Engineering, University of Prishtina, Kosovë

Nikolla P. Qafoku (niko_qafoku@yahoo.com),

Ph.D., Pacific Northwest National Laboratory, Richland, Washington, USA

Pandi Zdruli (pandi@iamb.it),

Ph.D., International Centre for Advanced Mediterranean Agronomic Studies (CIHEAM),
Mediterranean Agronomic Institute of Bari, Italy

Roza Allabashi (roza.allabashi@boku.ac.at),

Dipl.Ing. Dr., University of Natural Resources and Applied Life Sciences, Vienna, Austria

Zeqirja Neziri (zekoneziri@yahoo.com),

Prof. Dr., Faculty of Philology, University "St. Cyril and Metodij", Skopje, Macedonia

REDAKTOR TEKNIK / TECHNICAL EDITOR

Roland Lelaj (rlelaj@yahoo.ca)

Të dashur lexues,

Instituti Alb-Shkenca (IASH) është një organizatë jo fitimprurëse me 8 seksione shkencore ku bëjnë pjesë anëtarë që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të botës. IASH organizon çdo vit takimin vjetor i cili ka për qëllim paraqitjen dhe njohjen e arritjeve shkencore, shkëmbimin e përvojës, si dhe mundësimin e krijimit të një klime bashkëpunimi midis studiuesve shqiptarë.

Takimi i Dytë i Institutit Alb-Shkenca (IASH) u mbajt më 15-16 gusht 2007 në Prishtinë, Kosovë. Në këtë kuadër u mbledhën në kryeqytetin kosovar anëtarë të IASH-së, shkencëtarë të tjerë, studentë e dashamirës të shkencave nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora për të marrë pjesë në konferencat e ndryshme sipas interesit shkencor. Përveç paraqitjes së punimeve shkencore, gjatë takimit u krijuan njohje personale dhe u vendosën kontakte profesionale midis shkencëtarëve me interesa të përbashkëta.

Bordi drejtues i IASH-së vendosi që punimet e paraqitura gjatë këtij takimi të mund të botohen në një numër të veçantë të revistës ANASH dhe autorizoi Këshillin e Botimeve për të ndjekur këtë proces. Autorët e interesuar paraqitën punimet e tyre origjinale të formatuara sipas një shablloni të botuar paraprakisht si dhe kritereve të tjera të bazuara në përvojën shkencore ndërkombëtare. Dorëshkrimet e paraqitura u vlerësuan për formën dhe përmbajtjen e tyre nga dy recensentë identiteti i të cilëve nuk ishte i njohur nga autorët. Këshilli i Botimeve i IASH-së caktoi për këtë punë recensentët më të kualifikuar në fushat përkatëse dhe i këshilloi ata që të përdorin ekspertizën e tyre më të mirë për vlerësimin e punimeve. Këshilli gjithashtu vendosi për pranimin ose jo të dorëshkrimeve në bazë të rekomandimeve të recensentëve duke synuar që punimet e botuara të kenë nivelin më të lartë shkencor. Punimet e pranuar së fundi iu paraqitën Redaksisë së revistës ANASH për botim.

Punimet në këtë numër të veçantë janë paraqitur sipas seksioneve shkencore. Numri i parë i vëllimit përfshin punimet e Albanologjisë ndërsa numri i dytë gjithë shkencat e tjera. Redaksia e ANASH-it përgëzon autorët për botimet e tyre dhe në të njëjtën kohë falenderon pa masë recensentët, pa kontributin e të cilëve ky botim nuk do të kishte qenë i mundur.

Ju urojmë lexim të këndshëm

Dear reader,

Institute Alb-Shkenca (IASH) is a nonprofit organization of Albanian scholars and other members living in different countries and organized within the IASH framework into 8 scientific divisions according to their expertise and field of research.

International annual meetings of IASH are uniquely focused to promote scientific development, exchange of experience and create networking opportunities.

Members, scientists, students, and others assembled in Prishtinë, Kosova on August 15-16, 2007 to participate in the Second International Annual Meeting of IASH. During the meetings participants attended different conferences, presented their scientific achievements and networked as well.

It seemed fitting and appropriate that IASH decided to publish the scientific papers presented during the meetings. An editorial board managed the entire process. Submitted manuscripts underwent a double blinded review by at least two carefully selected research scientists of the same or similar field. The editorial board decided on the acceptance of the manuscripts based on the reviewers' recommendations, the scientific content, and originality and novelty of the work.

Papers in this volume are presented by scientific divisions: Albanology papers are included in Issue 1 while paper of others sessions are included in Issue 2.

The editorial board congratulates authors and reserves special acknowledgment to the contribution of the reviewers.

FJALA E HYRJES NË TAKIMIN VJETOR NËDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS

Zonja dhe Zotrinj,

Kam privilegjin dhe kënaqësinë e veçante që të hap Takimin e Dytë të Institutit Alb-Shkenca. Me këtë rast duke ju uruar mirëseardhjen në Kosovën e shumëvajtur e cila qysh kur në Vlorë hapi krahët në qiellin shqiptar shqiptarja dykrenare, ajo mbeti jashtë hijes së këtyre krahëve. Mbeti nën sundimin gati shekullor e me plot peripeci, duke mbajtur të gjallë flakadanin e lirisë gjatë dhjetëvjeçarëve të mohimit shumëdimensional përfshi këtu edhe atë kulturor dhe shkencor.

Sot, në momentet e hapjes së këtij takimi historik të Alb-Shkencës, nuk mund të mos nxjerr në pah mishërimin e këtij instiuti gjithëkombëtar me historinë e kombit tonë që invazionet sllave dhe vuajtjet historike e patën shtyrë nga thellësia e Ballkanit në brigjet e Adriatikut. Në këto mishërime historike më lejoni të kujtoj një të ri shqiptar, i cili i etur për nektarin e diturive shkencore pasi kreu Universitetin e Tiranës, mori rrugën e largët përtej oqeanit, arriti në Amerikën e Madhe, burimi më i thellë i shkencës dhe teknologjisë botërore. Ky i ri duke u ngjitur në majat e shkencës, i lodhur nga peripecitë e kësaj maratone shkencore, një natë mori frymë thellë duke kujtuar me nostalgji Shqipërinë dhe shqiptarët, me admirim por edhe me zili; kujtoi veprat e mëdha të Skënderbeut, Ismail Qemalit, Isa Buletinit e të tjerëve për bashkimin e shqiptarëve. Mendoj por edhe gjeti një zgjidhje origjinale të bashkimit të trurit dhe elitës shkencore dhe kulturore shqiptare. Këtë bashkim ai e bëri në truallin e shekullit 21, në hapësirën digjitale duke themeluar Institutin Alb-Shkenca.

Ky i ri i atëhershëm është Dr. Niko Qafoku i cili qysh nga momenti i themelimit të IASH-së, me devotshmëri të paparë kujdeset për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e saj në shërbim të kombit dhe shkencës në përgjithësi. Nga hapësira digjitale Alb-Shkenca zgjati rrënjët e saj fizike në trojet e mbarë shqiptarëve. Në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup u themeluan bazat e saj, zyrtat koordinuese dhe organizativo-shkencore.

Në këtë takim të dytë të IASH-së kanë ardhë studiues shqiptarë nga shumë vende të botës dhe secili mban me vete një përvojë, një histori të mishëruar me kombin. Ndër ta do të veçoja një vajzë të re gjyshi i së cilës, Qa-

zim Komani, para 60 vitesh pat ardhë nga Shqipëria si prijës ushtarak me shumë trima të tij për ta liruuar Kosovën. Bashkë me shokët e tij arriti ta bëjë këtë dhe marshoi nga Prizreni në Ferizaj, Mitrovicë e deri te Tutini. Por, siç e dimë ndodhi ajo e pa dëshirueshmja dhe heroi Qazim Komani përfundoi në burgjet serbo-sllave ku edhe humbi përgjithmonë, ai dhe eshtrat e tij. Sot, mbesa e heroit nuk ka ardhë për të gjetë eshtrat e gjyshit të saj. Ajo e di që ato eshtra sikur edhe të shumë shiptarëve të UÇK-së i kanë tretë hordhitë serbe nga frika në Danub apo humnerat në thellësi të Serbisë. Ajo nuk ka ardhë as për të qajtë mbi ato eshtra, ngase për to, sikurse shumë eshtra të bijve kosovarë kanë qajtë dhe akoma sot derdhin lotë nanat dhe motrat kosovare. Ajo në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të IASH-së sot ka zbritur nga një qendër europiane, nga Vjena e Austrisë, si eksperte e shkencave ekonomike dhe politike për të rekrutuar dhe organizuar trurin e ri shqiptar në IASH. Kje e re, që unë e quaj Shote Galica e shekullit 21, e mbesa e Qazim Komanit është Lindita Komani e cila së bashku me mua dhe Nikon do ta udhëheqi këtë takim shkencor.

Duke hapë këtë takim që konstiston, sikurse edhe vetë stuktura e IASH-së, në sesionet shkencore të cilat do të mbahen në tri ditët e ardhshme, kam dëshirë të theksoj që organizimi ynë është shumë demokratik dhe me aspirata të një pune të mirëfilltë shkencore europiane apo botërore.

Dua të përmend në mënyrë të veçantë edhe revistën tonë shkencore ANASH- Approaching Science për të cilën pretendojmë që të ketë një njohje të gjerë, me numrin e saj ndërkombëtar ISSN dhe me një këshill botues me emra që kanë një profil shkencor të mirënjohur në arenën ndërkombëtare.

Përveç problemeve shkencore bazë, problemet ekonomike, ato demokratike, të energjisë, ndotjes dhe sfidat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare do të jenë pjesë e programeve që do të percjellin jo vetëm këtë konferencë por edhe punën e ardhshme të IASH-së në vitet që do të vijnë.

Duke falenderuar të gjithë të pranishmit dhe qytetarët e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe të tjerëve kudo në botë, që me kureshtje percjellin zhvillimin e këtij takimi dhe punën e IASH-së në përgjithësi, ju uroj mirëqenie dhe suksese në veprimtarinë dhe qëllimet tuaja shkencore dhe ato për kombin.

Prof. Dr. Jahja Kokaj

Kryetar i Komitetit Organizativ të Takimit
Prishtinë, Gusht 2007

PASQYRA E LËNDËS

Gjendja e studimeve albanologjike dhe perspektiva e tyre BEGZAD BALIU	7
Studimet albanologjike në Maqedoni dhe perspektiva e tyre ZEQIRJA NEZIRI	15
Gjendja dhe perspektiva e sociolinguistikës shqiptare MUSTAFA IBRAHIMI	23
Gjendja e kërkimeve onomastike në Luginën e Preshevës dhe të Bujanocit BAHTIJAR KRYEZIU	35
Aspekte të mitikes dhe mistikes në etninë shqiptare, elemente të ballafaqimit dhe dialogut të përpjekjeve historiko-fonologjike dhe mitiko-semantike mbi origjinën dhe zhvillimin e gjuhës shqipe LLUKA QAFOKU	55
Përdorimi i shprehjeve të huazuara në gjuhën shqipe dhe hartimi i një fjalori për to ALI JASHARI	65
Vetëmjaftimi i letërsisë (ose kur liria prodhon vlera shpirtërore) EMIN KABASHI	75
Hundorësia e zanoreve të gegërishtes vështruar nga pikëpamja fonologjike ASLLAN HAMITI	81
Ali Pashë Tepelena dhe etnitë e pashallëkut të Janinës në vrojtimet e Likut SHPRESA HOXHA	91
Datimi i objekteve të kultit në rajonin e Voskopojës me metodën radiokarbonike, ELVIN TOROMANI, ANESTI POSTOLI	97
DOSSIER: JETA DHE VEPRAT E NDRË MJEDËS	105
Mbi gjëndjen dhe perspektivën e studimeve mjedologjike MENTOR QUKU	107
Refleksione mbi poemën <i>Andrra e jetës</i> të Ndre Mjedës SKËNDER DRINI	117

Pikëpamje leksiko-frazeostilistike të poemave jasonetike të Mjedës ZENUN GJOCAJ	121
Konkordancat dhe fjalët-çelës të poezisë së Ndre Mjedës NEBI ÇAKA, ALI ÇAKA	127
Çështje të zhanrit dhe estetikës në poezitë e Ndre Mjedës ADIL OLLURI	137